



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova–Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor
PROKURORIA THEMELORE / OSNOVNO TUŽILAŠTVO / BASIC PROSECUTION
GJAKOVË - DAKOVICA

AD.nr.02/2025

Dt.10.04.2025

Gj a k o v ë

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore Gjakovë, duke vendosur lidhur me çështjen disiplinore të iniciuar sipas ankesës të paraqitur nga përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit [REDAKTUAR] – avokati [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR], ndaj prokurorit së Prokurorisë Themelore në Gjakovë/Departamenti Përgjithshëm [REDAKTUAR], që ka të bëjë me trajtimin e çështjes penale PP/II.nr. [REDAKTUAR], konform nenit 9 par.1 pika.1.5 dhe par.6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7 par.3 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e paraqitur nga përfaqësuesi i të dëmtuarit [REDAKTUAR] – avokati [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR], ndaj prokurorit së Prokurorisë Themelore në Gjakovë/Departamenti Përgjithshëm [REDAKTUAR], sepse nuk ekzistojnë shkelje disiplinore nga neni 6 par.1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

A r s y e t i m

Autoritetit Kompetent me datë 19.03.2025 nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, ka pranuar kërkesën e paraqitur nga përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit [REDAKTUAR] – avokati [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR], ndaj prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë/Departamenti Përgjithshëm [REDAKTUAR], lidhur me çështjen penale PP/II.nr. [REDAKTUAR].

Pretendimet lidhur me dyshimet për shkelje disiplinore;

Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit [REDAKTUAR] – avokati [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR], në ankesën e tij ndër tjera ka cekur mos përfundimin e procedurës penale ndaj të dyshuarit [REDAKTUAR] për uzurpim të pronës, derisa në këtë rast tani ekzistojnë prova të mjaftueshme për ngritjen e aktakuzës derisa në raste të njëjta dhe të ngjashme sipas praktikës është dashtë deri tani të ngritet aktakuza dhe rasti të merr një epilog gjyqësor, duke shtuar se i dëmtuari është pronar i lokalit i cili gjendet nën pushtimin e të dyshuarit i cili nuk ka asnjë të drejtë në këtë patundshmëri, në këtë situatë edhe duke marrë parasysh se i dëmtuari është i regjistruar në Zyrën

kadastrale si pronar 1/1 i pronës e uzurpuar, shtrohet pyetja pse prokurori i rasti nuk e mbron të drejtën pronësore e të dëmtuarit dhe deri tani nuk i ka mare asnjë vendim lidhur me kallëzimin penal, andaj në këto rrethana neve nuk na nevojitet sqarime shtese nga prokurori i rastit, por një aksion i juaj në drejtim të zbatimit të procedurave Ligjore nga Prokuroria Themelore në Gjakovë edhe një here kërkoj vëmendjen tuaj në këtë rast në veçanti nëse nuk keni kompetenca ligjore në drejtim të disiplinimit të prokurorit dhe ndikimit në aspekt institucional ky rast të trajtohet si denoncim ndaj prokurorit [REDAKTUAR].

Veprimet e autoritetit kompetent;

Kërkesa si e tillë është pranuar në regjistrin adekuat dhe është trajtuar si ankesë që ka të bëjë me çështje disiplinore ndaj prokurorit dhe për këtë është njoftuar Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Më pas janë analizuar në hollësi të gjitha pretendimet e paraqitura në ankesë, po ashtu duke vepruar konform nenit 9 par.5 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, nga prokurori është kërkuar raport me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra në këtë çështje penale dhe pretendimet e paraqitura në ankesë.

Raporti i prokurorit të çështjes;

Prokurori i çështjes në raportin e tij ndër tjera ka cekur se kjo është shkresa e tretë e parashtruar nga av. [REDAKTUAR] dhe për dy shkresa të tjera ka dhënë përgjigje për Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, duke sqaruar gjithë rrjedhën e procedurës, respektivisht ndërmarrjen e të gjitha veprimeve në lëndën penale PP/II.nr. [REDAKTUAR] sa i përket të dyshuarit [REDAKTUAR].

Në këto përgjigje ka theksuar se përveç tjerash kemi autorizuar zyrtarët policor, respektivisht hetuesin [REDAKTUAR] disa herë për ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme, e po ashtu ndaj të njëjtit kemi autorizuar edhe Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK) që të ndërmerr veprime ndaj këtij hetuesit për shkak se i njëjti nuk ka zbatuar autorizimet e prokurorit të shtetit.

Për shkak të neglizhencës së hetuesit në ndërmarrjen e veprimeve hetimore, IPK me dt.10.03.2025 ka parashtruar raport informues, i cili raport për Prokurorinë e Shtetit është procesverbal i marrjes në pyetje të hetuesit [REDAKTUAR], e që me dt.19.03.2025 pranë prokurorisë parashtron raport informues në të cilën theksohet se çfarë veprime ka ndërmarr e të cilat po ashtu janë të mangëta, ku ndër të tjera theksohet se nga ana e policisë është bërë edhe kërkesë ILECU-t që përmes tyre të mundësohet prezenca e personit [REDAKTUAR] që i njëjti të intervistohet në bazë të autorizimit të prokurorit dhe se janë në pritje nga ILECU lidhur me kërkesën e bërë që të ju kthejnë informata lidhur me kërkesën si më lartë.

Ashtu siç kemi sqaruar në shkresat e mëparshme drejtuar zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit ku kemi sqaruar se janë ndërmarr një mori veprimesh lidhur me këtë çështje penale juridike, të cilat edhe do të ja bashkëngjisim kësaj përgjigje, në mungesë të veprimeve hetimore nga zyrtari hetues [REDAKTUAR], ka qenë e pamundur që të merret vendim meritör.

Ashtu siç thamë më lartë me dt.19.03.2025 kemi pranuar raport informues nga zyrtari hetues, mirëpo edhe këtij raporti i mungon deklarata e të dëmtuarit [REDAKTUAR].

Të gjeturat e autoritetit kompetent;

Autoriteti kompetent pasi që ka vlerësuar dhe analizuar pretendimet e paraqitura nga pala ankuese, pastaj përgjigjen apo raportin e prokurorit ndaj të cilit është paraqitur ankesa, sa i përket pretendimeve të ankuesit lidhur me veprimet apo mosveprimet e prokurorit të çështjes, ndër tjera konstatohet se prokurori këtë çështje e ka trashëguar nga prokurori [REDAKTUAR].

Në këtë çështje penale ndër tjera konstatohet fillimisht nga prokurori [REDAKTUAR] i cili ka qenë i ngarkuar me këtë lëndë, me datë 30.05.2023 është lëshuar autorizim drejtuar policisë për marrjen e veprimeve.

Me datë 05.10.2023 nga ana e policës është paraqitur raport informues nga i cili konstatohet se nuk është marr deklarata e palës së dëmtuar.

Me datë 08.03.2024 prokurori ka paraqitur kërkesë në zyrën e arkivës së prokurorisë, për të siguruar të dhënat në lidhje me çështjen penale PP/II.nr. [REDAKTUAR].

Me datë 08.03.2024 prokurori ka autorizuar policinë për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, duke përsëritur autorizimin e njëjtë me datë 06.08.2024, për ndërmarrjen e veprimeve konkrete.

Me datë 17.07.2024 prokurori ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Themelore Gjakovë, për të verifikuar nëse është duke u zhvilluar procedurë në mes të [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR].

Gjithashtu, prokurori i çështjes ka kthyer përgjigje Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit me dt.08.10.2024 dhe dt. 08.11.2024 duke sqaruar gjithë rrjedhën e procedurës, respektivisht ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të ndërmarra në lëndën penale PP/II.nr. [REDAKTUAR] sa i përket të dyshuarit [REDAKTUAR].

Në rastin konkret nga prokurori i çështjes janë autorizuar zyrtarët policor, për ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme, e po ashtu ndaj hetuesit [REDAKTUAR] ka autorizuar edhe Inspektoratin Policor të Kosovës, për shkak se i njëjti nuk ka zbatuar autorizimet e prokurorit të shtetit. Me dt.10.03.2025 IPK ka parashtruar raport informues lidhur me veprimet e tyre.

Me dt.19.03.2025 zyrtari policor ka paraqitur raportin informues, në të cilin mungon deklarata e të dëmtuarit [REDAKTUAR], ku ndër të tjera theksohet se nga ana e policisë është bërë edhe kërkesë ILECU-t që përmes tyre të mundësohet prezenca e personit [REDAKTUAR] që i njëjti të intervistohet në bazë të autorizimit të prokurorit dhe se janë në pritje nga ILECU lidhur me kërkesën e bërë që të ju kthejnë informata lidhur me kërkesën si më lartë.

Përfundimi;

Kryeprokurori në cilësi të autoritetit kompetent, në bazë të cekurave më lartë, analizimit të çështjes lidhur me ankesën e palës, nga raporti i prokurorit në lidhje me çështjen penale konkrete, po ashtu nga shkresat e lëndës, autoritetit kompetent vjen në përfundim se prokurori i çështjes ka ndërmarr veprimet e nevojshme në bazë të dispozitave ligjore përkatëse dhe në kuadër të kompetencave ligjore të prokurorit të shtetit, andaj në veprimet e prokurorit nuk ekzistojnë shkelje disiplinore konform nenit 6 par.1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Për arsyet e lartcekura u vendos si në dispozitiv të vendimit.

T'i dorëzohet :

- Këshillit Prokurorial të Kosovës
- [REDACTED] - Njoftim me shkrim
- Shkresave të lëndës

